



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:084677
Datë: 14.03.2024
Numri i dokumentit: 05449277

PAKR.nr.729/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Bashkim Hyseni – kryetar i kolegjit, Vatton Durguti dhe Afërdita Bytyçi – anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Endrit Ajeti, në çështjen penale ndaj të akuzuarve Xh.B. dhe B.T., secili veç e veç për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesave, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të akuzuarit B.T., mbrojtësit të akuzuarit Xh.B. av. S. M., ankesën e përbashkët të mbrojtësve të të pandehurit B.T. av. A.V. e av. F.L., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.155/22, të datës 30.09.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPRK-së, më datë 12.09.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.Me aprovimin e pjesshëm të ankesës, si të bazuar, të mbrojtësve e të akuzuarit B.T. av.A.V. dhe av.F.L., përkitazi me vendimin mbi dënimin, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.155/22, i datës 30.09.2022, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarin B.T. për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite. Në pjesën tjetër aktgjykimi i ankimuar mbetet i pa ndryshuar.

II.REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e Prokurorit të Shtetit, mbrojtësit e të akuzuarit Xh.B. av. S.M., ankesa e të akuzuarit B.T. dhe në pjesën tjetër e mbrojtësve të tij, av. A.V. dhe av. F.L., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.155/22, i datës 30.09.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.155/22, të datës 24.11.2022, të akuzuarit Xh.B. dhe B.T. i ka shpallur fajtor për shkak të kryerjes secili veç e veç të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, ashtu që të akuzuarit iu ka shqiptuar dënim me burgim, dhe atë të pandehurit Xh.B. në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, ndërsa të pandehurit B.T. në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, të cilin dënim të akuzuarit do ta mbajnë, nga dita kur aktgjykimi merr formë të prerë.

Konform nenit 62 par. 2 pika 2.3 të KPRK, të akuzuarve: Xh.B. e B.T., iu ka shqiptuar dënimi plotësues, ndalim i ushtrimit të funksionit në administratën publike, në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, i cili dënim do të ekzekutohet pas mbajtjes së dënimit me burgim nga të akuzuarit.

Ka obliguar të akuzuarit Xh.B. e B.T., që të dëmtuarës M.I., në mënyrë solidare t’ia kompensojnë dëmin e shkaktuar në shumën prej 29,824.18€, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, por jo më vonë se dy vite.

Të akuzuarit Xh.B. e B.T. i ka detyruar secili veç e veç që konform nenit 3 par.3.2 të Ligjit për kompensimin e viktimave të paguajë shumën prej 50 € për Fondin e viktimave.

Ka detyruar të akuzuarit që t’i paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç, shumën prej nga 200 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

- Prokuroria Themelore në Prishtinë, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.155/22, të datës 24.11.2022 të ndryshohet sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, ashtu që të akuzuarit Xh.B. dhe B.T. për veprën penale për të cilën janë shpall fajtor t’iu shqiptohet një dënim më i lartë.
- I akuzuari B.T., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, si dhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa, ashtu që aktgjykimi PKR.nr.155/22, të datës 24.11.2022 të ndryshohet dhe të lirohet nga akuza për shkak se nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet apo që eventualisht aktgjykimi i ankimuar të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.
- Mbrojtësit e të akuzuarit B.T. av. A.V. e av. F.L., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, si dhe kërkesës pasurore juridike, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi PKR.nr.155/22, të datës 24.11.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda të ndryshohet, ashtu që i pandehuri të lirohet nga akuza për shkak se nuk është provuar se ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet apo që eventualisht aktgjykimi i ankimuar të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.
- Mbrojtësi i të akuzuarit Xh.B. av. S.M., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi PKR.nr.155/22, të datës 24.11.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda si i pa bazuar në ligj, ashtu që i pandehuri të shpallet i pa fajshëm ose lënda të kthehet në rigjykim.

- Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit B.T. av. A.V., me propozim që Gjykata e Apelit ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kurse në anën tjetër ta aprovoj ankesën e mbrojtjes duke nxjerr aktgjykim lirues.

Prokuroria e Apelit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.9/2023, të datës 11.01.2023, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ashtu që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe ndaj të akuzuarve të shqiptohet një dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje më të lartë, sesa me aktgjykimin e ankimuar. Ndërsa të refuzohet si e pa bazuar ankesa e parashtuar nga mbrojtësi i të akuzuarit Xh.B. av. S.M. dhe ankesa e parashtuar nga i akuzuari B.T..

Gjykata e Apelit e caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-se në të cilën ishin prezentë të akuzuarit: Xh.B. e B.T., dhe mbrojtësit e të akuzuarve Xh.B. av. S.M., dhe B.T.av. A.V., ndërsa nuk ishte askush nga Prokuroria e Apelit, mbrojtësi i të akuzuarit B.T.av. F.L., dhe e dëmtuara M.I., edhe pse kanë qenë të njoftuara në mënyrë të rregullt për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi shkresat e lëndës në këtë çështje së bashku me aktgjykimin e ankimuar, të cilat i vlerësoi konform dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPRK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve të theksuar në ankesa, gjeti se: Ankesa e mbrojtësve të akuzuarit B.T. - av.A.V. e F.L. janë pjesërisht të bazuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, ndërsa ankesa e Prokurorisë, e mbrojtësit të akuzuarit Xh.B.-av.S.M., dhe në pjesën tjetër ankesa e të akuzuarit B.T. dhe mbrojtësve të tij av. A.V. e F.L., janë të pabazuara.

Pretendimet ankimore:

Prokurori i Shtetit në ankesë pretendon se dënimet e shqiptuara nga gjykata e shkallës së parë janë të ulëta me peshën e veprave penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale, sepse të akuzuarit veprat penale i kanë kryer me dashje direkte duke ushtruar funksionet zyrtare. Andaj prokuroria konsideron se sanksionet penale kundër të akuzuarve nuk janë adekuate me veprën e kryer nga ana e të akuzuarve dhe sanksioni është dashur të jetë më i ashpër sepse në rastin konkret gjykata nuk i ka zbatuar drejt rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit në raport me peshën e veprës Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK. Tutje ka shtuar

se dënimi për dy të pandehurit është jo i drejtë, jo proporcional, andaj vlerësojmë se ndaj të pandehurve duhet të shqiptohet një dënim më i lartë dhe nuk është arsye të theksohet se Xh.B. është më pak përgjegjës sesa B.T., pra edhe Xh.B. ka përgjegjësi jashtë zakonisht të madhe sepse ka qenë sekretar i përgjithshëm-pozicioni më i lartë në ministri, ku bënë administrimin dhe menaxhimin e gjithmbarshëm të ministrisë, sigurimin e implementimit të funksioneve që u janë besuar, menaxhimin efektiv dhe efikas të resurseve që i janë siguruar ministrisë, e këto janë funksionet që e bëjnë dënimin të jetë më i lartë. Prokuroria konsideron se gjykata edhe përkundër faktit që ka marr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese në përcaktimin e dënimin, e njëjta nuk ka vepruar në mënyrë proporcionale me peshën e veprave penale dhe pasojën e shkaktuar, kështu që i shqipton dënimet e përcaktuara si në aktgjykimin e atakuar, me çka konsiderojmë se këto dënime janë të buta në krahasim me peshën e veprave penale dhe pasojën e shkaktuar, andaj me dënimet e tilla nuk mund të arrihet qëllimi i dënimin. Bazuar në këto arsye kërkon nga gjykata që të vendos në favor të ankesës.

I akuzuari B.T. në ankesë pretendon se Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të karakterit absolut dhe relativ të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, par. 1 dhe par. 2, pasi që: a) aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 të KPPRK-së. Gjykata tashmë vetëm ka shtuar deklarimin e H.M., aty ku citon provat e administruara, dhe nuk ka shtjelluar dëshminë e H.M. (dëshmitari kyç i cili ka qene edhe kryetar i komisionit për vlerësim se bashku me M.E. dhe H.D. të cilët kanë vazhduar punën me rekomandimin për dhënien të tenderit OE, "S." si ofertues i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Në aspektin përmbajtësor dëshmia e tij është thelbësore në këtë rast, që dëshmon se OE F. kishte mungesë të dokumentacionit (e vërtetuar edhe me të gjitha deklarimet e pronarit dhe inxhinierit të OE F.) dhe nga të gjitha shkresat e lëndës, dhe se OE S. ishte oferta e suksesshme me çmimin më të ulët, e gjitha kjo e vërtetuar edhe në këtë proces gjyqësor, pra në të kundërtën si të shpallet fitues oferta e papërgjegjshme???. Këto gjykata e shkallës së parë nuk i ka shtjelluar, as vërtetu drejte dhe sakte sipas gjendjes faktike në këtë proces. Deklarimi i dëshmitares E.A. ka version krejt ndryshe nga të gjithë dëshmitarët e tjerë dhe provat shkresore të administruara, e ku fjala e E. është edhe komplet aktgjykimi i marrë në rastin konkret, kështu që detyrohet ti paraqes faktet që dëshmojnë se deklarimi i E. është tendencioz, i pa vërtetë dhe hakmarrës për interes të saj dhe familjarëve të saj. I gjithë arsyetimi në rigjykim, trupi gjykues potencon njëjtë se dëshmitarja deklaroi se, dëshmitarja ka deklaruar se duke i pranuar si të tilla pa asnjë argument dhe dëshmi faktike, ku ndër të tjera trupi gjykues konstaton se „I njëjti sipas ligjit ka kompetencë ta refuzoj raportin e komisionit ose vetë të vendos lidhur me operatorin e suksesshëm, pasi që ai vërtetë ka pasur

kompetencë ta bëjë këtë, por që është përpjekur që të mos lë gjurmë përkitazi me veprimet e kundërligjshme, edhe pse argumenton në aktgjykim se me procese tjera ka refuzuar vlerësimin e komisionit në dy raste të tjera” (prova nr. 1 dhe nr. 2. Pra si mund të vlerësoj trupi gjykues si më lartë dhe të konstatoj se ushtrimi i kompetencës ligjore qenka veprim i kundërligjshëm?. Ky trup gjykues as në rigjykim nuk ka arritur të vërtetoj saktë dhe të drejtë gjendjen e plotë faktike në pajtim me nenin 7 të KPPRK???. Tutje ka shtuar se ajo që është shqetësuese për mua është edhe dëshmia e H.M. i cili ishte kryetar i komisionit që përfundoj procedurën. Dëshmia e tij tani e renditur e cila ishte fshirë fare nga procesi gjyqësor sikurse te mos prezantohej fare. Ne aspektin përmbajtjesor dëshmia e tij është thelbësore ne këtë rast, që dëshmon se OE F. kishte mungese te dokumentacionit (e vërtetuar edhe me te gjitha deklarimet e pronarit te OE F.) dhe se OE S. ishte oferta e suksesshme me çmimin me te ulet, e gjitha kjo e vërtetur edhe ne këtë proces gjyqësor, pra ne te kundërtën si te shpallej fitues oferta e papërgjegjshme???. Ne anën tjetër gjykata e shkallës së parë thirret edhe ne dëmtimin e MI për 29,824.18 euro, ku ne këtë proces nuk është vërtetuar asgjë nga pretendimet e Prokurorit te Shtetit pos thirrjes ne deklarate të E.A. pas asnjë mbështetje ne prova dhe shkresa te lendes apo deklarimet e dëshmitareve tjerë dhe pronarit te vete kompanisë “F.” i cili në deklarimet e tij në të gjitha fazat e këtij procesi vërteton/dëshmon se nuk ka i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe në këtë proces nuk ka bërë ankesë dhe as nuk ndihet palë e dëmtuar. Pra si mund të konstatohet se M.I. qenka dëmtuar nga një proces i drejtë dhe i rregullt tenderimi dhe vlerësimi të ofertave, e kundërta sikur të shpallej fitues “OE F.” atëherë do të kishte shkelje të kriterëve të tenderit. Në procesin e rigjykimit kemi kërkuar edhe angazhimin e një eksperti të prokurimit për të nxjerrë ekspertizë të prokurimit dhe angazhimin e një eksperti financiar, ekspertizë financiare për të nxjerrë vlerësimin e pretenduar të dëmtimit të Ministrisë, mirëpo këto kërkesa janë refuzuar nga trupi gjykues i shkallës së parë. Si rezultat i një refuzimi të tillë nuk është vërtetuar saktë, drejtë, dhe në mënyrë të plotë gjendja faktike në këtë rast. Për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Mbrojtësit e të akuzuarit B.T.av. A.V. e av. F.L. në ankesë pretendojnë se aktgjykimi i ankimuar është përpiluar në kundërshtim me nenin 370, par. 1,2,4,6,7, dhe 8 te KPRK-së. Në këtë drejtim i njëjti nuk përmban arsyetim cilësor, ashtu që shpesh herë paraqitet kontradiktor dhe në mospërputhje me dispozitivin e aktgjykimit.

Aktgjykimi është në kundërshtim me nenin 365 të KPPRK, kështu gjykata duke u mbështetur në deklaratat e E.A. ka shpallur fajtor B.T. për veprën penale të cekur si në aktakuzë. Deklarata e lartë cekur është provë e vetme fajësuese mbi të cilat është gjetur fajtor i akuzuari. Një ndër arsye se pse nuk duhet falet besimi një deklarate të tillë është arsyeja se deklarata e saj të dhënë

para organeve proceduese nuk ishte koherentë dhe në konsistencë me njëra tjetrës. E. në deklaratën e dhënë para Policisë së Kosovës më datë 01.02.2017 kishte deklaruar se „Jam detyruara të përgatis një kërkesë për tërheqje nga komisioni dhe jam obliguar që data e kërkesës të jetë më e hershme se data e raportimit”, në prokurori me datë 17.08.2017 kishte deklaruar se „Kërkesën për tërheqjen e ka bërë drejtori nga komisioni dhe më ka urdhëruar që aty për aty ta nënshkruaj kërkesën për tërheqje nga komisioni pa dëshirën tim”, kurse para gjykatës me datë 12.03.2021 kishte deklaruar se „ ...me nënshkruaj këtë kërkesë për tërheqje shkaku i angazhimeve e që i kam pas sipas kërkesës që është përpiluar nga tjetër kush por që është nënshkruar nga unë”, „ ...së bashku me kërkesën e gatshme për nënshkrim kinse dorëheqjen kam kërkuar unë dhe njëjtë kam nënshkruar se kam qenë e obliguar dhe e kërcënuar”. Siç mund të shihet e njëjta dëshmitare pranon të qëndroj para deklaratave të dhëna në polici, gjersa në të njëjtën kohë i ofron gjykatës deklaratat tejet të ndryshme nga ato të dhëna në polici. Aktakuza e paraqitur nga prokurori i shtetit nuk ka përshkrim se si është realizuar në tërësi procesi i paraqitjes së kësaj kërkesë nga ana e E.A., dhe si është detyruar kjo e fundit, pra në faqet 28,29,30,33,34, dhe 35 të aktgjykimit të ankimuar gjykata vetëm përmend se E. është detyruar të paraqes dorëheqje, por jo mënyrën se si.

Edhe pse aktgjykimi i ankimuar është mbështetur vetëm në deklaratën e dëshmitares E.A., e njëjta iu kishte shmangur disa herë thirrjeve të gjykatës, kurse në seancën e datës 29.07.2022 av.F.L. i kishte propozuar gjykatës të urdhërohet që nga Sistemi i Integruar i Kufirit të nxirreshin të gjitha hyrjet daljet për E. në vendkalimin kufitar për periudhën 20.05.2019-12.03.2021, ky propozim ishte refuzuar nga gjykata. Ky propozim kishte qenë edhe në harmoni me aktvendimin e Gjykatës së Apelit përmes së cilës është kthyer në rivendosje, ngase e njëjta gjykatë ka orientuar shprehimisht në vërtetimin e saktësisë së deklaratave të kësaj dëshmitares. Përveç aktgjykimit të ankimuar, mangësi dhe paqartësi janë paraqitur edhe në aktakuzën PP/L.nr.38/2017, të datës 23.01.2018, ku e njëjta është përpiluar në kundërshtim me nenin 241 par. 1, nën par. 4 të KPP.

Dëmi i pretenduar nuk është konstatuar me ndonjë ekspertizë profesionale. Kështu në aktakuzën PP/L.nr.38/2017, të datës 23.01.2018 është pretenduar se dy të pandehurit i kanë shkaktuar dëm Ministrisë së Infrastrukturës dëm në shumë prej 29,824.18€, kurse lartësia e këtij dëmi nuk është konstatuar me asnjë ekspertizë profesionale. Në seancën e datës 30.09.2022 avokati i të akuzuarit XH.B., e për të cilën propozim e ka përkrah edhe mbrojtja e B.T., ka propozuar caktimin e një eksperti, kurse gjykata të njëjtin propozim e kishte refuzuar, ku nuk ka arsyetuar fare refuzimin e këtij pretendimi.

Gjykata ka vepruar në kundërshtim me nenin 370 të KPP-së, ngase mbrojtësi i të akuzuarit XH.B. bazuar në nenin 141, par. 2 të KPPRK-së i ka propozuar gjykatës që në cilësinë e provës të merret një ekspertizë e përpiluar më mjetet vetanake të palës mbrojtëse të Xh.B., mirëpo ky propozim është refuzuar nga ana e gjykatës, me një arsyetim të përmbledhur në një paragraf prej pesë rreshtave. Kurse në dispozitën e nenit 370, par. 7 të KPP është përcaktuar se “Gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij”. Kështu që mos përfshirja e propozimeve në aktgjykimin e ankimuar dhe arsyetimet e dhëna nga gjykata janë në kundërshtim me dispozitën e lartë cekur.

Gjykata nuk ka përfillur kërkesat e caktuara në aktvendimin PAKR.nr.24/2022 të Gjykatës së Apelit, ku kishte potencuar se „...në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të sqaroj dhe të vërtetoj saktësinë e deklarimeve të dëshmitareve kyçe V.R. dhe E.A., po ashtu edhe deklaratën e dëshmitarit H.M.”. Edhe pse gjykata e shkallës së parë në aktgjykim ka përmendur se përfill sugjerimet e marra nga Gjykata e Apelit, ky pretendim nuk është fare i vërtetë.

Aktgjykimi i ankimuar është shumë kontradiktor, sepse gjykata në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar ka shpallur fajtorë dhe ka dënuar dy të akuzuarit për shkak secili veç e veç ka kryer veprën penale 442, par. 1 të KPRK, gjersa pjesa arsyetuese e vendimit paraqet një realitet krejt tjetër nga dispozitivi. Sipas gjykatës ka ekzistuar plani për kryerjen e veprës penale, e pas këtij plani që të dy kanë ndërmarë veprimet për kryerjen e veprimeve të kundërligjshme, gjegjësisht të shkaktojnë pasojën e dëshiruar, pra ka ndodhur e kundërta e asaj për të cilën janë dënuar te pandehurit.

Në rastin konkret kemi shkelje të ligjit penal, ngase gjykata me rastin e vendosjes nuk ka shtjelluar fare elementet e veprës penale sipas paragrafit 1 të 422 të KPRK. Gjykata nuk ka përcaktuar fare nëse B.T. ka kryer veprën penale duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar. Gjykata në vendimin e saj ka anashkaluar në tërësi akuzën e prokurorisë në lidhje me tejkalimin e kompetencave të B.T. Sipas gjykatës, vepra penale ka rezultuar vetëm nga shfrytëzimi i detyrës apo autoritetit zyrtar. Nga kjo rrjedhë paqartësia se cili është qëndrimi faktik dhe juridik i gjykatës lidhur me tejkalimin e kompetencave të T. Prokuroria nuk ka ndryshuar asnjëherë

aktakuzën e saj sa i përket tejkalimit të kompetencave nga ana e B.T. dhe për këtë arsye gjykata është dashur ta qartësoj në detaje arsyetimin se përse nuk ka shpallur fajtor të akuzuarin sipas aktakuzës. Gjykata askund nuk ka konstatuar se cilën dispozitë ligjore paska shkelur B.T. që veprimet e tija të konsiderohen të kundërligjshme, rrjedhimisht dispozitivi i gjykatës është i pa bazuar dhe pjesa arsyetuese e vendimit nuk është në përshtatshmëri me këtë pjesë të vendimit. Kundërligjshmëria e veprimeve të B.T. nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme, e që rrjedhimisht mungon baza e krimit të kësaj veprë penale përmes shfrytëzimit të detyrës apo autorizimeve zyrtare. Kështu edhe nëse është ngjarja ashtu siç ka pretenduar prokuroria, tek i akuzuari nuk ka ekzistuar dashja direkte për kryerjen e veprës penale, ngase asnjë nga provat e paraqitura nga prokuroria në aktakuzë nuk e vërteton ekzistimin e dashjes dhe qëllimit të akuzuarit për të kryer veprën penale me qëllim të përfitimit apo dëmtimit të personave tjerë.

Në rastin konkret gjithashtu mungon lidhja shkak-pasojë (kauzale) e veprës penale, ngase shihet qartë se nuk ka lidhje zingjyrore në mes veprimeve të pandehurit B.T. dhe përzgjedhjes së OE „S.” si operator fitues i tenderit.

Tutje ka shtuar se gjatë gjithë procedurës prokuroria nuk ka arritur ta provojë se është ushtruar presion mbi E. dhe se B.T. ishte involvuar në punën e komisionit. Dy anëtarët e tjerë të komisionit kanë deklaruar se nuk kanë pasur asnjë presion nga B.T., prandaj duke pasur parasysh faktin se nga tre anëtarët kanë qenë dashur që të jenë së paku dy vota që të aprovohet rekomandimi, pretendimet e E. janë të palogjikshme. Ne deklarimet e saja E. në asnjë moment nuk ka përmendur se i është ushtruar ndonjë forcë apo kanosje serioze.

Vërtetimi i gabuar ose jo i plotë të gjendjes faktike, konsiston në faktin se gjykata nuk ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte, me cilat prova, në çfarë mënyre vërtetohen, duke mos vërtetuar në mënyrë të kujdesshme as provat kundërthënëse. Gjykata ka vërtetuar në bazë të kalkulimeve të gabuara dëmin e pretenduar të shkaktuar me vepër penale. Dëmi i pretenduar nuk është përcaktuar me ekspertizë profesionale ashtu siç do të duhej. Gjykata ka vlerësuar gabimisht pa ndonjë ekspertizë profesionale se operatori ekonomik „S.” është zgjedhur fitues i tenderit në mënyrë jo të rregullt dhe jo ligjore, përkundër faktik se i njëjti operator është zgjedhur i përgjegjshëm dhe fitues i tenderit sipas një raporti të nxjerrë nga një procedurë e rregullt dhe legjitime. Sipas gjykatës operator ekonomik fitues do duhej të zgjidhej operatori ekonomik „F.” edhe përkundër faktik se i njëjti operator është zgjedhur i papërgjegjshëm me raportin e vlerësimit, pasi i njëjti kishte përfshirë inxhinierin e tij në më shumë se një projekt ndërtues. Gjykata ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike të atillë se të akuzuarit në

bashkëkryerje kanë kryer veprën penale nga neni 442, par. 1 të KPRK, ndërsa janë dënuar secili veçmas veç e veç. Me rastin e vendosjes gjykata ka marrë parasysh vetëm provat fajësuese dhe tejet të kontestueshme dhe vendimin ndaj të akuzuarit B. e bazon në deklaratat e pa vërteta të E.A. Gjykata nuk ka arritur të shpjegoj se pse disa dëshmitarëve u ka falur besimin në tërësi, ndërsa disa dëshmitarëve tjerë jo, ku te gjitha provat tjera dhe sidomos deklaratat e dëshmitarëve kanë qenë shfajësuese për të akuzuarin B.

Vendimi mbi sanksionin penal dhe kërkesën pasurore juridike, konsiston ne faktin se nëse shikohet dispozitivi i aktgjykimit në asnjë pjesë të tij nuk përmendet se veprimi i B.T. i ka shkaktuar dëm financiar Ministrisë së Infrastrukturës, madje kjo e fundit asnjëherë nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike me të cilën do të kërkohej kompensimi i dëmit të pretenduar nga ana e prokurorisë. Gjithashtu është paradoksale se si në arsyetimin e njëjtë Xh.B. është ulur dënimi nga 3 vite në 2 vite burg, ndërsa për B.T. lartësia e dënimit ka mbetur e njëjtë, sikurse ishte edhe me aktgjykimin e mëhershëm, tashmë të anuluar, andaj mbrojtja konteston në tërësi dënimin e shqiptuar, ngase i njëjti dënim është i pa mbështetur dhe nuk rezulton nga provat e ofruara në shkresat e lëndës. Gjykata ka shkelur parimet fundamentale të drejtësisë me rastin e matjes së dënimit, përkatësisht me rastin e matjes së rrethanave lehtësuese dhe atyre rënduese. Për Xh.B., gjykata ka marrë si rrethanë lehtësuese faktin se ndaj tij nuk është duke u zhvilluar asnjë procedurë gjyqësore. Element ky që lë të nënkuptohet indirekt se ndaj B.T. zhvillimi i procedurave tjera gjyqësore ndaj tij është duke u marrë si rrethanë rënduese edhe pse nuk ishte administruar asnjë provë për të vërtetuar këtë gjendje faktike, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

- Mbrojtësi i të akuzuarit Xh.B. av. S.M. në ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, par. 1, pika 12, dhe par. 2, pika 2.1 dhe 2.2. Janë bërë shkelje të dispozitave nga neni 369, par. 7 të KPP, ngase gjykata ka vepruar në kundërshtim me nenin 370, par. 7 sepse nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se në cilat fakte dhe për çfarë arsye e konsideron si të vërtetuar faktin se i akuzuari Xh.B. ka ndërmarr veprime për kryerjen e veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK, nuk ka treguar arsyet e refuzimeve të propozimeve të mbrojtjes, kurse me anë të këtij aktgjykimi nuk është sqaruar kundërthënia e provave. Gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore si në rastin kur flitet për vërtetimin e dashjes, po ashtu edhe të ekzistimit të veprës penale për të akuzuarin. Të vetmen provë që përmendet dhe bazohet në të është prova personale, përkatësisht deklarata e dëshmitares V.R., ndërsa nga ana tjetër fare nuk merr parasysh deklaratat e dëshmitarëve siç janë: A.Zh., M.E.,

H.M., H.D., Z.A., E.A. Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të nenit 384, par. 2, pika 2.1 të KPP, nuk ka zbatuar apo ka zbatuar gabimisht nenin 3 (parimi In Dubio Pro Reo), 5, 7, 136, 262, 405 të KPP, të cilat kanë pasur ndikim në nxjerrjen e një vendimi të drejte dhe të ligjshëm. Kështu në mungesë të provave për vërtetimin e fajësisë dhe ekzistimin e veprës penale është dashur të merret parasysh neni 3 të KPP, dhe të akuzuarin ta liroj nga akuza, sepse nuk ka mundur të vërtetohen veprimet inkriminuese të pandehurit me asnjë provë materiale, e vetmja që e inkriminon të pandehurin është dëshmitarja V.R., por dëshmia e saj nuk gjen në asnjë provë materiale siç është: mesazh me shkrim, urdhër apo diçka tjetër. Aktgjykimi i ankimuar praqet edhe shkelje të nenit 136 të KPP-së, ngase në rastin konkret është dashur nga prokuroria apo më pas edhe nga gjykata që së pari dëmi që supozohet që i është shkaktuar Ministrisë së Infrastrukturës të ishte vërtetuar me anë të ekspertizës financiare, apo ekspertiza nga fusha e prokurimit që të vërtetohet fajësia apo pafajësia, shkalla e fajësisë e të pandehurve. Kështu mbrojtja e të pandehurit Xh.B. në rigjykim ka kërkuar që të bëhen këto ekspertiza sepse i shërbejnë vërtetimit të drejtë dhe real të gjendjes, mirëpo një gjë e tillë është refuzuar nga gjykata, dhe drejtë është kaluar në fjalën përfundimtare, e që vërtetohet edhe nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, të datës 30.09.2022. Në të njëjtën kohë gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të nenit 262 të KPP, ku është përcaktuar se „Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale”, ngase fajësia e të pandehurit Xh.B. sipas kësaj gjykate në tërësi konsiderohet si e vërtetuar duke u bazuar vetëm në deklaratën e dëshmitares V.R., të cilës i ka dhënë rëndësi vendimtare, madje gjykata në aktgjykim thekson se kjo është provë e pranueshme sepse i pandehuri Xh. nuk i ka bërë dëshmitares V. paraqitje për deklaratë të rrejshme, e ky pretendim i gjykatës është në tërësi në kundërshtim me nenin e sipër theksuar. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë nuk iu është përmbajtur udhëzimeve të dhëna nga Gjykata e Apelit, të cilat janë saktësuar në mënyrë të qartë në aktvendimin PAKR.nr.24/2022.

Shkelje të ligjit penal, ekziston për faktin se me aktgjykimin e atakuar është bërë shkelje të dispozitës nga neni 385, par. 1, nen par. 1.1 „vepra për të cilën i akuzuari ndiqet nuk është vepër penale”; 1.2 „ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale” dhe 1.5 „në marrjen e vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore” të KPP, sepse nuk ka vërtetuar në mënyrë objektive elementet e përgjithshme dhe të veçanta të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale ashtu siç parashihet në kapitullin e dytë të KPRK-së. Kështu për të kryer një person një vepër

penale duhet të plotësohen katër elementet e veprës penale: Veprimi, kundërligjshmëria, përcaktueshmëria dhe fajësia, e nëse njëri nga këto elemente mungon atëherë nuk ka veprë penale. Gjykata Themelore ka dështuar në vërtetimin e elementit subjektiv, përkatësisht fajësisë, si dhe elementet objektive e që është kundërligjshmëria, kështu duke shkelur nenin 21 të KPRK. Sa i përket elementit të parë të veprës penale-veprimi i të pandehuri Xh.B. me të cilën konsiderohet se ka kryer veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK, nuk është sqaruar fare se si ka ardhur deri tek vërtetimi se ekziston një veprim i pa ligjshëm i cili ka dëmtuar apo ka shkaktuar pasoja të dëmshme, pasi që i pandehuri Xh. duke zbatuar Ligjin nr.03/L-189, nenin 48 ka qenë sekretar i përgjithshëm i M.I., i cili është udhëheqës administrativ i ministrisë, që raporton drejtpërdrejt ministrit, andaj i pandehuri Xh.B. ka qenë duke vepruar në tërësi brenda kompetencave të tija të përcaktuara me ligj, edhe në rastin kur ka bërë nxjerrjen e vendimit të datës 21.06.2016. Vendimi 2549/1 i nxjerrë nga Xh.B. për ndryshimin e komisionit të prokurimit vërtetohet se është nxjerrë në Qershor dhe jo ashtu siç e ka arkivuar arkivistja V.R., sepse në vendimin e nxjerrë nga sekretari thuhet se po vepron sipas kërkesës së datës 16.05 dhe 21.06 të vitit 2016 e që nënkupton se po vepron për kërkesat e një muaji pas datës është protokolluar vendimi. Pra nëse sekretari do ta urdhëronte V.R. - arkivistin që ta protokollonte vendimin 2549/1 një muaj më herët, respektivisht me datë 23.05.2016 atëherë do të ishte më e logjikshme që edhe vet sekretari kur të ketë nxjerrë vendimin të mos kishte shkruar se po vepron sipas kërkesës së datës 21.06.2016. Pra është e pamundur që sekretari të ketë vepruar sipas kërkesës së ardhshme dhe është e palogjikshme që sekretari ta ketë detyruar arkivistin ta regjistrojë vendimin të cilin vetë e ka lëshuar, respektivisht nxjerrë sipas kërkesës të datës 21.06.2016, një muaj më herët përkatësisht siç e ka protokolluar arkivistja me datë 23.05.2016. Kështu gjykata e shkallës së parë ka dështuar në vërtetimin e veprimit të cilin e ka ndërmarrë i pandehuri Xh. për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar, sepse vetëm deklarata e V.R. se e ka detyruar ta bëjë regjistrimin e tillë pa asnjë provë tjetër nuk e vërteton fajësinë e të pandehurit Xh.B. Në anën tjetër nuk është plotësuar elementi i dytë i veprës penale, e që është kundërligjshmëria sepse veprimi i të pandehurit Xh.B. nuk paraqet veprë penale, konkretisht nxjerrja e vendimit nr.2549/1 nuk paraqet kundërligjshmëri sepse është në tërësi në përputhje me Ligjin nr. 03/L-189, neni 48. Gjithashtu elementi i kundërligjshmërisë nuk është plotësuar as kur merret parasysh pretendimi se e ka detyruar V.R. që të bëjë protokollimin e vendimit një muaj më herët sepse një veprim i tillë i të pandehurit Xh.B. nuk është vërtetuar me asnjë provë, vetëm me deklaratën e V.R., e cila duke u munduar ta largojë përgjegjësinë nga vetja, këtë përgjegjësi ia lë Xh., ndërsa të njëjtën nuk mund ta vërtetojë me asnjë provë materiale.

Gjykata e shkallës së parë si në gjykimin e parë, ashtu edhe në rigjykim nuk ka arritur që të vërtetoj se në veprimet e të pandehurit të ketë ekzistuar dashja për të kryer veprën penale. Nga aktgjykimi i shkallës së parë, faqe 23 thuhet se “dashja dhe qëllimi i të akuzuarve për të vepruar kundërligjshëm, e provon dhe e dëshmon jashtë çdo dyshimi, përgatitja profesionale e të akuzuarve, pasi që të njëjtit janë deklaruar para kësaj gjykate se kanë përgatitje arsimore superiore, i akuzuari Xh.B. është afër gradës shkencore të doktorit të shkencave, si dhe që të dy janë deklaruar se kanë përvojë të gjatë, në lëminë e menaxhimit..., dhe një kalibër i tillë i intelektualëve nuk ka mundësi që veprimet e ndërmarra janë të kundërligjshme”, ky konstatim i gjykatës së shkallës së parë është skandaloz dhe arbitrar ku asnjëherë më parë nuk kemi parë që përgatitja profesionale të përdoret si fakt që vërteton fajësinë e të pandehurit, përkundrazi përgatitja profesionale në praktikën gjyqësore gjithëherë merret si rrethanë lehtësuese për të pandehurit në procedurë dhe jo si shkallë e përgjegjësisë apo fajit. Në anën tjetër me anë të provave të paraqitura që janë shqyrtuar është vërtetuar se Xh.B. asnjëherë nuk ka bërë ndikim tek asnjë anëtarë i komisionit, se asnjëherë nuk e ka detyruar asnjë zyrtarë apo arkiviste të ndërmarrë ose të mos ndërmarrë ndonjë veprim, i pandehuri asnjëherë nuk ka takuar asnjë person përgjegjës të operatorëve ekonomik, e kjo është vërtetuar me anë të provave materiale dhe personale.

Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, konsiston në faktin se dëshmitarja V.R. në deklaratën e saj të dhënë në shqyrtim të parë gjyqësor me datë 17.04.2019 ka deklaruar se nga fundi i orarit asistentja e sekretarit të përgjithshëm M.Rr. i ka thënë se vendimin me nr. 2549/1 duhet ta protokollon në rubrikën ku ishte i protokolluar një vendim tjetër i datës 23.05.2016 dhe sipas saj pasi ajo ka refuzuar ta beje këtë, sekretari i përgjithshëm e kishte thirrur dhe i kishte thënë merre librin e protokollit dhe eja larte, sipas kësaj dëshmitareje sekretari i përgjithshëm i kishte thënë se nuk do të ketë asnjë problem me punu me fraksione, dhe se dëshmitarja është ndjere keq gjate tere kohës sa e ka bere këtë dhe se pasi janë paraqitur krimet ekonomike dhe kane filluar ti bëjnë pyetje pikërisht për vendimin qe e ka protokolluar me date një muaj më herët përsëri Xh.B. - sekretari i ka thënë ta fshij në mënyrë që të mos ketë qasje krimet e rënda. Kjo deklaratë është tërësisht e pa baze me vete faktin se vendimi i cili është kontestues të cilin e ka nxjerre Xh.B. shkruan mjaft mirë se po nxirret sipas kërkesës së dt. 16.05.2016 dhe 21.06.2016, e nëse do donte sekretari ta protokollonte një muaj me herët atëherë edhe vendimin do ta bënte sipas kërkesave të një muaji me herët. Andaj këtu shihet qartë se ky vendim është nxjerrë vetëm sipas autorizimeve të cilat i ka pasur sekretari i përgjithshëm në suaza të Ligjit dhe Rregulloreve të M.I. Sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike lidhur me shkallavitjen në librin e protokollit kjo asnjëherë nuk e vërteton fajësinë e të pandehurit, sepse mbajtja e librit të protokollit nuk ka qenë

detyrë e sekretarit të përgjithshëm por detyrë e arkivistit, e cila i ka raportuar drejtorit të administratës në kuadër të ministrisë, dhe po ashtu nuk ka pasur as vijë hierarkike me sekretarin e përgjithshëm.

Shkeljet lidhur me vendimin mbi sanksionin penale, ekziston për faktin se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është tejet i lartë, dhe në kundërshtim me nenin 385, par. 1.5 dhe 387 të KPP, pasi që nuk merren fare parasysh rrethanat lehtësuese por vetëm rënduese. Në rastin konkret nëse do të kishte gjykim të drejtë i pandehuri do të ishte shpallur i pa fajshëm, ngase gjatë tërë procesit gjyqësor, me të gjitha provat është vërtetuar se i akuzuari Xh.B. nuk ka ndërmarrë veprimet inkriminuese, dhe se ka vepruar vetëm brenda kompetencave të tij. Për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, pasi analizoi aktgjykimin e ankimuar së bashku me shkresat e lëndës, e duke i vlerësuar pretendimin ankimor përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 2 nënpar.2.1 dhe 2.7 e të ndërlidhur me nenin 369 par. 8 të KPP-së, me aprovimin e pjesëshëm të ankesës së përbashkët të mbrojtësve e të akuzuarit B.T. - av.A.V. e F.L., përkitazi me vendimin mbi dënimin tani më ky pretendim ankimor mbetet i pa objekt, pasi që kjo Gjykatë bazuar në dispozitën e nenit 398 par.1 pika 1.4 e lidhur me nenin 403 par.3 të KPPRK-së, e ndryshoi aktgjykimin e gjykatës së shkallë së parë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ndërsa pretendimet tjera ankimore e të akuzuarit B.T. dhe mbrojtësve të tij av.A.V. e F.L., mbrojtësit e të akuzuarit Xh.B., av.S.M., përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 2 nënpar.2.1 dhe 2.7 e të ndërlidhur me nenin 369 par. 6, 7 të KPP-së janë të pabazuara, ndërsa duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, gjeti se në pjesën tjetër aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kishin për të kushtëzuar detyrimisht anulimin e tij, ngase dispozitivi i aktgjykimi është i kuptueshëm dhe i qartë, në të cilin janë përshkruar veprimet inkriminuese të cilat formojnë elementet e veprës penale për të cilin janë shpallur fajtor të akuzuarit dhe se i njëjti është në përputhshmëri të plotë me arsyetimin e tij.

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale-juridike, duke vepruar kështu konform dispozitës të nenit 369

par. 6 të KPPK-së, ku gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, si ato faktike ashtu dhe ato juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitën e nenit 360 par.1 dhe 2 të KPPK-së, kështu në rastin konkret, ka dhënë arsye të qarta dhe konkrete për vendin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e veprave penale andaj, nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, ka ardhur në përfundim se të njëjtit kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar dhe në këtë drejtim rrjedh se gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me të njëjtat ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimor të mbrojtëseve, av. A.V. e av. F.L., dhe av.S.M., se gjykata duke u mbështetur në deklaratat e E.A. ka shpallur fajtor B.T., si provë e vetme fajësuese mbi të cilat është gjetur fajtor i akuzuari, të vetmen provë që përmendet dhe bazohet në të është prova personale, përkatësisht deklarata e dëshmitares V.R., ndërsa nga ana tjetër fare nuk merr parasysh deklaratat e dëshmitarëve siç janë: A.Zh., M.E., H.M., H.D., Z.A., E.A. Kjo për faktin se, në këtë çështje penale, përpos vlerësimit të deklarimeve të dëshmitarëve të dëgjuar në këtë çështje penale, për vërtetimin e fakteve relevante gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e ankimuar e ka mbështetur edhe në provat tjera materiale të administruara në shqyrtim gjyqësor, të cilat do të eleborohen në vazhdim të këtij aktgjykimi, prandaj në këtë çështje penale, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 257 të KPP-së, si pretendon mbrojtësi i të akuzuarit Xh.B.-av.S.M., pasi që gjykata nuk i ka shpallur fajtor të akuzuarit duke u mbështetur vetëm në një deklaratë të dëshmitares, si pretendon mbrojtja si në ankesat e tyre, por ka vlerësuar të gjitha provat një nga një dhe në lidhje me provat tjera personale e materiale, ka ardhur në përfundim duke i gjetur fajtor të akuzuarit për veprat penale, si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, pretendimin ankimor të akuzuarit B.T.se, dëshmia e H.M., i cili ishte kryetar i komisionit që përfundoj procedurën, dëshmia e tij tani e renditur e cila ishte fshirë fare nga procesi gjyqësor, sikurse te mos prezantohej fare, e gjen të pabazuar për faktin se nga arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar rrjedh se gjykata e shkallës së parë ka analizuar dhe vlerësuar deklaratën e këtij dëshmitari në këtë çështje penale, e që kjo pasqyrohet si në fq.13, 26 të arsyetimit të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, pretendimin ankimor të mbrojtësve av.A.V. e F.L., se pse nuk duhet falet besimi një deklarate të tillë, dëshmitares E., është arsyeja se deklarata e saj të dhënë para organeve proceduese nuk ishte koherente dhe në konsistencë me njëra tjetrën, duke cituar më pas deklarin e saj, e që sipas mbrojtjes, kjo dëshmi e dëshmitares, E., është provë e vetme fajësuese mbi të cilat është gjetur fajtor i akuzuari, gjen se është pretendim i pabazuar. Kjo për faktin se, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar ka dhënë arsyet e qarta përkitazi me besueshmërinë e kësaj dëshmie, të cilën dëshmi pas analizimit e ka vlerësuar dhe ndërlidhur edhe në raport me dëshmi të dëshmitarëve të tjerë dhe provave materiale të administruara në këtë çështje penale, për vërtetimin e faktit relevant të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, dhe në këtë drejtim, përpos deklaratës së kësaj dëshmitare edhe nga provat tjera materiale rezulton të mos jetë kontestuese se kërkesa me shkrim për tërheqjen e saj nga pozita e kryetares së komisionit ekziston dhe si e tillë është proceduar në cilësinë e provës materiale andaj, edhe në raport me pretendimin se përveç aktgjykimit të ankimuar, mangësi dhe paqartësi janë paraqitur edhe në aktakuzën PP/I.nr.38/2017, të datës 23.01.2018, ku e njëjta është përpiluar në kundërshtim me nenin 241 par. 1, nën par. 4 të KPP, janë pretendimet e pabazuar pasi që në përshkrim faktik janë përshkruar rrethanat që përcaktojnë kohën dhe vendin-gjegjësisht hapësirat e M.I. - divizioni i prokurimit, ku janë ndërmarrë veprimet inkriminuese nga ana e të akzuarit, për të cilat gjykata e shkallës së parë i ka shpallur fajtor dhe gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimor të mbrojtësve e të akzuarve se dëmi i pretenduar nuk është konstatuar me ndonjë ekspertizë profesionale, ndërsa në seancën e datës 30.09.2022 avokati i të akzuarit Xh.B., për të cilën propozim e ka përkrah edhe mbrojtja e të akzuarit B.T., ka propozuar caktimin e një eksperti, kurse gjykata të njëjtin propozim e kishte refuzuar, ku nuk ka arsyetuar fare refuzimin e këtij pretendimi.

Në raport me këtë çështje të pretenduar, kolegji i kësaj gjykate pajtohet me qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë me arsyet si në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të dt.30.09.22, se vlera e dëmit që i është shkaktuar MI-së është diferenca në çmim në mes të ofertuesit të parë “F.”, (të cilën e ka rekomanduar komisioni i kryesuar nga dëshmitarja E.) dhe ofertuesit të cilin të akzuarit kishin për qëllim dhe dashje ti ipet ofertuesit të dytë, OE “S.”, dhe se për këtë diferencë në shumë monetare gjykata nuk ka parë të domosdoshme që të përcaktohet me ekspertizë financiare, pasi që lartësia e shumave të ofertuesve ishin të përcaktuar saktësisht dhe diferenca ndërmjet ofertave me shkrim ishin të llogaritshme.

Ndërsa, përkitazi me refuzimin e propozimit të mbrojtësve të akuzuarve të ekspertizës me shkrim të ekspertit të prokurimit, edhe kjo gjykatë pajtohet me arsyetimin gjykatës së shkallës së parë, si të drejtë dhe të ligjshëm, pasi që në këtë çështje penale, i akuzuari Xh.B. akuzohet që me dashje dhe qëllim të përfitimit pasuror e ka obliguar zyrtaren e arkivës së M.I., V.R., që në librin e Protokollit të regjistroj vendimin me numër 254/1 me të cilin vendim është ndërruar Kryetarja e Komisionit, E.A., e për të cilat veprime gjatë shqyrtimeve gjyqësore janë dëgjuar dëshmitarët dhe janë administruar provat materiale, ndërsa sa i përket të akuzuarit B.T., i njëjti akuzohet se ka ndërmarrë veprime me dashje dhe është pajtuar me shkaktimin e pasojës në mënyrë që ti mundësoj personit tjetër respektivisht operatorit OE “S.” përfitim pasuror, ku ka detyruar zyrtaren e prokurimit E.A. që të paraqes *kërkesë me shkrim për tërheqje* nga Komisioni vlerësuese, në mënyrë që të bëhet ndryshimi i vendimit numër 2140, me qëllim që tenderi ti jepet OE “S.”, pra të akuzuarit në këtë çështje penale akuzohen për veprimet tjera inkriminuese dhe jo për aspektet e procedurës së tenderimit, e që do të ishte e nevojshme të dëgjohej ndonjë nga eksperte në fushën e prokurimit publikë, andaj edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, me të drejtë gjykata e shkallës së parë kishte refuzuar këto dy propozime të mbrojtësve e të akuzuarve, ngase si të tillë nuk kishin për të kontribuar vërtetimit të ndonjë fakti relevant në këtë çështje penale në raport me veprimet faktike për të cilat gjykata e shkallës së parë të akuzuarit i ka gjetur fajtor dhe gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar

Andaj, kolegji i kësaj gjykata vlerëson se pretendimi i mbrojtësve të akuzuarve, av. A.V. e av. F.L. dhe av.S.M., se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni (370 par.7 KPP-së) 369 par.7 të KPPRK-së, është pretendim i pabazuar për faktin se kjo dispozitë, si e tillë, nuk kufizohet në dhënien e arsyeve për mosmiratim të propozimeve të palëve gjatë shqyrtimi gjyqësor, ngase vendimet të marrë gjatë shqyrtimi gjyqësor kundërshtohen me ankesë kundër aktgjykimit, si është edhe në rastin konkretë. Ndërsa, në anën tjetër, është fakt i pamohueshëm se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet mbi refuzimin e propozimeve të palëve, si në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të dt. 30.09.22, mbi bazën e të cilave janë ngritur këto pretendimet ankimore, andaj nga kjo rrjedh se në këtë çështje penal palëve nuk i është mohuar apo kufizuar e drejta në mjet juridik efektiv për shkak të mosdhënies së arsyeve për mosmiratim të propozimeve të palëve nga gjykata e shkallës së parë në fazat e caktuar si është përcaktuar me kodin e procedurës penale.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuara pretendimet ankimore të akuzuarit B.T. dhe mbrojtësve të tij av. A.V. dhe av.F.L., përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me

pretendim se gjykata nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte edhe me cilat prova i ka vërtetuar, faktin se gjykata e shkallës së parë pa ndonjë ekspertizë profesionale ka vërtetuar në bazë të kalkulimeve të gabuara dëmin e pretenduar të shkaktuar me veprën penale ngase ekspertiza e specializuar është e domosdoshme në mënyrë që të konstatohet fajësia e të pandehurve dhe dëmi i shkaktuar dhe kundërligjshmëria është element i cili shndërron veprimet e personave zyrtar në veprime penale për këtë arsye ky element është dashur të konstatohet saktë dhe në mënyrë profesionale me ekspertizë, po ashtu fakti se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka konstatuar se të akuzuarit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale për të cilën ngarkohen ndërsa janë dënuar secili veçmas – veç e veç, faktin se me rastin e vendosjes ka marrë parasysh vetëm prova fajësuese dhe tejet të kontestueshme dhe vendimin e bazon në deklaratat e pavërteta të E.A., faktin se nuk ka arritur të shpjegojë fare se pse disa dëshmitarëve u ka falur besimin në tërësi ndërsa disa dëshmitarëve të tjerë jo. Kjo për faktin se, gjykata e shkallës së parë, përkitazi me këto çështje të pretenduara, në aktgjykimin e ankimuar ka dhënë arsye konkrete dhe të kuptueshme se me cilat nga provat e administruara ka vërtetuar fakte vendimtare në këtë çështje penale, duke arsyetuar dhe çështjen e besueshmërisë apo jo besueshmërisë së dëshmitarëve, në këtë çështje penale.

Pretendimet si në ankesë, nga mbrojtësi i të akuzuarit Xh.B. av.S.M., lidhur me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, e që konsiston në mbështetjen e vendimit në deklaratën e dëshmitares V.R. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 17.04.2019, pasi që kjo deklaratë është tërësisht e pabazë me vetë faktin se vendimi i cili është kontestues të cilin e ka nxjerr Xh.B. shkruan mjaft mirë se po nxirret sipas kërkesës së datës 16.05.2016 dhe 21.06.2026, e nëse do donte Sekretari ta protokollonte një muaj më herët atëherë edhe vendimin do ta bënte sipas kërkesave të një muaji më herët, po ashtu edhe pretendimi se gjykatë e shkallës së parë nuk ka marrë fare parasysh deklaratat e dëshmitarëve si, A.Zh. i cili kishte deklaruar se nuk kishte pasur asnjë ndërhyrje nga ana e sekretarit, deklarata e dëshmitarit M.E. i cili deklaroi se asnjëherë nuk ka pasur presion nga ana e sekretarit, deklarata e dëshmitarit H.M. i cili ka deklaruar se asnjëherë nuk është ftuar të bisedojë nga sekretari, deklarata e dëshmitarit H.D. i cili ka deklaruar se asnjëherë nuk e ka takuar sekretarin gjatë procedurës së vlerësimit të tenderit Gj.-K., po ashtu në kundërshtim me këtë deklaratën e dëshmitares V.R. ka qenë deklarata e Z.A. i cili ka deklaruar se asnjëherë nuk e ka takuar këtë dëshmitarë në zyrën e Sekretarit, përkatësisht të pandehurit Xh.B., dhe se ai nuk ka dijeni për tenderin në fjalë e as për ndryshimin e Komisionit, e gjithashtu as nuk është në pajtim me dëshminë e E.A., e cila tregon se të njëjtës sekretari i ka thënë që “Kryeni ju punën tuaj”, dëshmi kjo e cila vërteton se i akuzuari Xh.B. me asnjë veprim nuk ka ndikuar tek kryetarja

e Komisionit, përkundrazi e ka udhëzuar që të veproj sipas detyrave të saja dhe pa ndikime, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate janë pretendimet e pabazuara ngase për të gjitha këto çështje, si në pretendim ankimor, gjykata e shkallë së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar ka dhënë arsye të qarta dhe konkrete se me cilat nga provat e administruara ka vërtetuar fakte vendimtare në këtë çështje penale.

Pretendimet e lartcekura se, gjykata e shkallës së parë, nuk i ka vlerësuar drejtë dëshmitë e dëshmitarëve të propozuar, e disa deklaratat shfajësuese nuk i ka vlerësuar fare (si deklaratën e H.M., M.E., H.D. si dhe deklaratat e prova të tjera që gjenden në shkresat të lëndës), sipas vlerësimit të kësaj Gjykate janë të pabazuara për faktin se, nga arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar rrjedh se gjykata e shkallës së parë i ka analizuar dhe vlerësuar edhe këto dëshmi të dëshmitarëve, nga të cilat dëshmi dhe provat materiale pas vlerësimit të secilës prej tyre dhe të ndërlidhura me njëra tjetrën ka ardhur në përfundim duke vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit i kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar, për të cilin pajtohet edhe kjo Gjykatë si përfundim i drejtë dhe i ligjshëm në këtë çështje penale.

Gjykata e Apelit gjen se gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se të akuzuarit Xh.B. dhe B.T. secili veç e veç janë kryes të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, për të cilën janë shpallur fajtor, si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë, nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka vërtetuar se të akuzuarit Xh.B. dhe B.T., si në përshkrim faktik të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, kanë kryer secili veç e veç veprën penale për të cilat janë shpallur fajtor, në atë mënyrë që i akuzuari Xh.B., gjatë vitit 2016, derisa ishte Sekretar i Përgjithshëm, në M.I., në P., në cilësinë e personit zyrtar, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, ka ndërmarrë veprime të kundërligjshme dhe është pajtuar me shkaktimin e pasojës, ashtu që i njëjti në mënyrë që t'i mundësoj personit tjetër, respektivisht Operatorit Ekonomik N.N.T. "S.", përfitim pasuror, me dashje, e ka obliguar zyrtaren e arkivës të asaj Ministrie, V.R., që në librin e protokollit të regjistroj vendimin me numër 2549/1, me të cilin vendim është ndërruar Kryetarja e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin "Zgjerim i rrugës nacionale N-9, segmenti: Gj. – K., sektori, D LOTI-Gj.-Ll., km 0+000,00-3+300,41", i cili vendim mban datën 23.06.2016, dhe regjistrohet me datë 23.05.2016, me qëllim që tenderi t'i ipet Operatorit Ekonomik, N.N. T. "S.",

i cili ishte me çmim më të lartë prej 29,824.18 €, se Operatori Ekonomik, “F.” dhe të njëjtit i pamundësohet fitimi i tenderit edhe pse ishte ofertë më e lirë.

Ndërsa i akuzuari B.T., gjatë vitit 2016, derisa ishte ushtrues i detyrës së Drejtorit në Divizionin e Prokurimit, në M.I., në P., në cilësinë e personit zyrtar, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, ka ndërmarrë veprime të kundërligjshme dhe është pajtuar me shkaktimin e pasojës, ashtu që, në mënyrë që t’i mundësoj personit tjetër, respektivisht Operatorit Ekonomik N.N. T. “S.”, përfitim pasuror, me dashje, ka detyruar zyrtaren e prokurimit E.A., që të paraqes kërkesë me shkrim, për tërheqje nga Komisioni, të tenderit me numër MI 16-029 511, të datës 26.05.2016, dhe të bëhet ndryshimi i vendimit me numër 2140 të datës 29.04.2016, me qëllim që tenderi t’i ipet Operatorit Ekonomik NNT “S.” edhe pse për nga çmimi ishte më i shtrenjtë për 29,824.18 €, se sa OE “F.”, pasi, Kryetarja e Komisionit, nuk ka pranuar që ta ndryshoj raportin e vlerësimit të tenderit, me të cilin ishte shpallur fitues OE “F.”.

Deri tek kjo gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë ka ardhur pas administrimit të provave si ato personale: dëgjimi i dëshmitares V.R., dëgjimi i dëshmitarit A.Zh., dëgjimi i dëshmitarit M.E., dëgjimi i dëshmitarit H.M., dëgjimi i dëshmitarit H.D., dëgjimi i dëshmitarit Z.A., dëgjimi i dëshmitares V.R., dëshmitari Sh.K., në emër të përfaqësuesit të Kompanisë “F.” ashtu edhe nga administrimi i provave materiale siç janë: Raporti i vlerësimit të tenderit MI 16-29-511, i datës 26.05.2016, kërkesa për referencën me numër 09/16 e datë 16.05.2016, në emër të E.A., kërkesë kjo e cila ka të bëjë me tërheqjen nga Komisioni me numër 35/16, dt.21.06.2016, Vendimi lidhur me emërimin e Komisionit për hapjen e ofertave për projektin “Zgjerim i rrugës Nacionale N9, Segmeti Gj. – K., sektori D, Loti Gj.- Ll. Kilometri 0+000, 00-3+30041” me Nr. të referencës 2044, dt: 26.04.2016, Vendimi për caktimin e komisionit për vlerësimin me numër 2140 të datës 28.04.2016, Vendimi me numër 2549/1, datë 23.05.2016, për ndryshimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave i protokolluar me numër 3415 datë 23.06.2016, raporti i vlerësimit të tenderëve me numër të prokurimit MI 16036521, dt.27.05.2016, njoftimi për refuzimin e vlerësimit për aktivitetin e prokurimit i të pandehurit B.T. dt.21.07.2016.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuara pretendimet ankimore e të akuzuarit B.T. dhe mbrojtësve të tij, se i akuzuari nuk ka kryer veprën penale që i vihet në barrë. Kjo për faktin se, nga shkresat e lëndës, vërtetohet se i akuzuari me dashje direkte dhe vetëdije të plotë ka ndërmarrë veprimet inkriminuese për kryerjen e veprës penale Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së dhe është pajtuar me shkaktimin e pasojës - dëmtimin e MI-së, e që rrjedh

nga kronologjia e rastin në fjalë. Fakti i vërtetuar, se i akuzuari B.T., në mënyrë të kundërligjshme e detyroi, ku paraprakisht kërkonte nga kryetarja e komisionit, E.A., që si kryetare e komisionit ta ndërroj raportin e vlerësimit të tenderit me numër të pro: MI-16-029-511, e më pas ka kërkuar edhe ndryshimin e përbërjes së Komisionit, pas përfundimit të vlerësimit nga ana e komisionit paraprak në krye me E.A. – kryetare, meqenëse e njëjta ka kundërshtuar ndërrimin e raportit të vlerësimit të tenderit të datës 26.05.2016, e që më pas ka rezultuar me paraqitjen e kërkesës me shkrim për tu tërhequr nga komisioni pa dëshirën e saj, me qëllim që në mënyrë të kundërligjshme ti mundësoj përfitim pasuror OE “S.”, gjen mbështetje si në deklarin e dëshmitares E.A. e po ashtu edhe në provat e tjera materiale të lartcekura, si në shkresat e lëndës, të cilat janë administruar në shqyrtimi gjyqësor të kësaj çështje penale.

Po ashtu, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të paraqitura nga mbrojtësi i të akuzuarit Xh.B. se i njëjti nuk ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet, është i pabazuar, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se i akuzuari me dashje direkte dhe vetëdije të plotë ka ndërmarrë veprimet inkriminuese për kryerjen e veprës penale Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së dhe është pajtuar me shkaktimin e pasojës - dëmtimin e MI-së, e që vërtetohet edhe nga fakti se i akuzuari Xh.B. në cilësinë e personit zyrtar si Sekretar i M.I. së Republikës së Kosovës me dashje, në mënyrë të kundërligjshme, ka obliguar zyrtaren e arkivës, V.R., që në librin e protokollit të regjistroj vendimin me numër 2549/1, i cili vendim e mban datën 23.06.2016 dhe e detyron që ta regjistroj me datën 23.05.2016, një muaj më vonë, me qëllim që tenderi që ka të bëjë me zgjerimin e rrugës nacionale N9 segmenti Gj. – K. Sektori D Loti Gj. – L., t’i ipet OE N.N.T. “S.” në mënyrë të kundërligjshme, ngase raporti i vlerësimit të tenderit që mban datën 26.06.2016 nga komisioni për vlerësimin e tenderëve në përbërje nga E.A. - Kryesuese, H.D. dhe M.E. – Anëtarë edhe pse ka rekomanduar për lidhje të kontratës me OE “F.” me tu dorëzuar raporti i vlerësimit të tenderit, i akuzuari Xh.B. me qëllim që ky tender mos ti ipet OE “F.”, edhe pse ishte rekomanduar nga ky komision, i akuzuari nxjerr vendimin me nr.2549/1 të datës 23.05.2016 për ndryshimin e komisionit me numër 2140 dhe 2549/1 për vlerësimin e ofertës që kishte të bënte me projektin “Zgjerimi i rrugës nacionale N-9 segmenti Gj. – K., sektori D-LOTI –Gj. – Ll., duke caktuar me vendim H.M. – Kryetar, H.D. dhe M.E. – Anëtar, e gjithë kjo me qëllim që OE “S.” ti mundësohet nënshkrimi i kontratës, e më pas ti ipet tenderi edhe pse i njëjti kishte konkurruar me çmim më të shtrenjtë, 991.418.19 euro, se operatori i parë, në diferencë prej 29,824.18 euro, duke dëmtuar kështu buxhetin e MI-

së, fakte këto vendimtare në këtë çështje penale që janë vërtetuar nga prova të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, të cekura si më lart.

Mbi gjendjen faktike të konstatuar, gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar ligjin penal kur të akuzuarit Xh.B. dhe B.T. i ka shpallur fajtor për veprën penale Keqpërdorim i pozitës dhe autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, për shkak se është vërtetuar se të njëjtit kanë kryer veprën penale për të cilën ngarkohen ashtu si ka pretenduar prokuroria në aktakuzë dhe nga provat e administruara kanë rezultuar si të provuara tiparet e kësaj vepre penale si dhe kanë qenë të përshkruara veprimet inkriminuese si në dispozitiv të aktakuzës e që formojnë elementet e figurës së veprës penale për të cilën janë akuzuar të akuzuarit.

Gjykata e Apelit gjen se në këtë çështje penale nuk ka shkelje të ligjit penal si pretendon mbrojtja e të akuzuarve në ankesë, kjo për faktin se në gjendjen faktike të provuar nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve qëndrojnë elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor të akuzuarit, të njëjtit janë penalisht përgjegjës ndërsa në anën tjetër nuk ekziston asnjë nga rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale e të akuzuarve.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimor të mbrojtësve të akuzuarit B.T., av. A.V. e av. F.L., se gjykata me rastin e vendosjes nuk ka shtjelluar fare elementet e veprës penale sipas paragrafit 1 të nenit 422 të KPRK, dhe se Gjykata nuk ka përcaktuar fare nëse B.T. ka kryer veprën penale duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar. Po ashtu, pretendim e mbrojtësit e të akuzuarit Xh.B., av.S.M., se nuk është sqaruar fare se si ka ardhur deri tek vërtetimi se ekziston një veprim i pa ligjshëm i cili ka dëmtuar apo ka shkaktuar pasoja të dëmshme, pasi që i pandehuri Xh. duke zbatuar Ligjin nr.03/L-189, nenin 48 ka qenë sekretar i përgjithshëm i M.I., i cili është udhëheqës administrativ i ministrisë, që raporton drejtpërdrejt ministrit, andaj i pandehuri Xh.B. ka qenë duke vepruar në tërësi brenda kompetencave të tija të përcaktuara me ligj, kjo gjykatë i gjen të pabazuar këtë pretendim të mbrojtjes. Kjo ngase gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit, nga fq. 23, ka dhënë arsyet konkrete për veprimet e ndërmarra inkriminuese nga të akuzuarit duke dhënë arsyet se në cilat provat dhe fakte ka mbështetur për të vërtetuar mënyrën e kryerjes së veprës penale nga të akuzuarit në këtë çështje penale.

Gjykata e Apelit vlerëson se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë ka zbatuar drejtë ligji penal duke i shpallur fajtor të akuzuarit, secilin veç e veç, për veprën penale Keqpërdorimi

i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së. Kjo për faktin se në vërtetim të gjendjes së plotë dhe të drejtë faktike për veprimet inkriminuese, si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, rezulton se në këtë çështje penale fitohen elementet e veprës penale për të cilat gjykata e shkallë së parë i ka shpallur fajtor të akuzuarit, pasi që të njëjtit duke *keqpërdorë pozitën zyrtare*, në mënyrë të kundërligjshme kanë detyruar vartësit e tyre, këtu dëshmitaret, V.R. dhe E.A., që të veprojnë konform kërkesave të tyre, e në kundërshtim me obligimet dhe detyrat e tyre zyrtare, e për qëllimet e përfitimi të personit tjetër.

Si është elaboruar dhe arsyetuar në aktgjykimin e ankimuar dhe në këtë aktgjykim, i akuzuari Xh.B. duke keqpërdorë pozitën e tij zyrtare, Sekretar i Përgjithshëm në MI, e ka detyruar zyrtaren e arkivës, V.R., në atë mënyrë që në përfundim të orarit të punës së asaj dite, kërkon që ajo të merr regjistrin dhe të shkoj në zyrë të tij, duke e detyruar që të regjistroj vendimin e tij, duke i shtuar fraksion numrit të vendimit (2549/1) të nxjerrë më vonë, në një rubrikë ku ishte një vendim tjetër i datës 23.05.2016, pra në datat e mëhershme, gjë të cilën dëshmitarja e kishte kundërshtuar dhe njoftuar se nuk veprojnë, mirëpo ai i kishte thënë se nuk do të ketë asnjë problem, pasi që ai më parë kishte punuar në Komunë edhe atje kanë punuar me fraksione dhe se këto janë të ligjshme, dhe kreu këtë me qëllim që të formohet komisioni tjetër vlerësues, me qëllim që ky tender ti ipet OE “S.” dhe jo ofertuesit më të lirë, OE “F.”, në këtë procedurë të tenderimit. Në anën tjetër dëshmitarja, E.A. në deklarimin e saj, ndër të tjera, fq.16.17, të aktgjykimit të ankimuar, kishte dëshmuar se rreth tenderit ka pas kontakte me sekretarin Xh.B., të cilin e ka njoftuar se në zyrën e saj ka qenë N.S., nga kompania “S.”, dhe kjo kishte ndodh para se ajo të caktohet kryetare e komisionit, por ai e ka ditë (N.S.), që ajo do të caktohet anëtare e komisionit, duke shtuar më tutje se ajo si kryetare e komisionit nuk ka pas komunikim me dikë tjetër lidhur me këtë projekt, përveç operator S., i cili ka qenë në zyrën e saj dhe i ka thënë se “kjo është punë e kryme dhe unë do ta marrë këtë projekt” pasi sipas tij ai përbrenda Ministrisë, ka pas informata që ai ka me fitua këtë tender, e që kjo bisedë me operatorin “S.” ka qenë para se komisioni ta dorëzoj raportin vlerësues lidhur me operatorin e suksesshëm, duke shtuar se operatori “S.” i ka thënë se “unë kam informata se ju jeni në komision” edhe atë para se të formohet komisioni. Ndërsa, Drejtori i prokurimit, i akuzuari B., i kujtohet se i njëjti i kishte thënë “mos e shpallni F. fitues, se kanë me shpall në Pestovë, në një projekt tjetër”. Pra, nga këto rrethana rrjedh se i akuzuari Xh.B., si person zyrtar kryen veprën penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar duke shfrytëzuar detyrën zyrtare në atë mënyrë që ndërmerr veprimet të cilat formalisht janë në kuadër të autorizimeve të tij, pra marrjes së vendimit për formim të komisionit për vlerësim të ofertave, por në kundërshtim me interesat dhe detyrat e shërbimit, duke ndërhyrë -

detyruar zyrtarët në punët e rregullta të tyre, ashtu që detyrën e tij me qëllim e ka shfrytëzuar për ti sjell dobi operatorit “S.” e në anën tjetër duke shkaktuar dëm interesave të shërbimit për të cilat kishte detyrë që të kujdesej.

Ndërsa, edhe i akuzuari B.T., si është elaboruar dhe arsyetuar në aktgjykimin e ankimuar dhe në këtë aktgjykim, duke keqpërdorë pozitën e tij zyrtare, ud. Drejtor në Divizionit të Prokurimit, e ka detyruar zyrtaren e prokurimit, E.A., që të paraqes kërkesë me shkrim për tërheqje nga komisioni vlerësuar nga tenderi me nr.MI 16-029 511, me qëllim që të bëhet ndryshimi i vendimit nr. 2140 të datës 29.04.2016, me qëllim që tenderi ti ipet OE “S.”, pasi që ajo nuk ka pranuar që ta ndryshoj raportin e vlerësimit të tenderit me të cilin kishin rekomanduar OE “F.”, si operator, gjë që nga dëshmia e dëshmitares rrethanat e tilla si të vërtetuara gjen mbështetjen edhe në provat materiale si në shkresat e lëndë, andaj i akuzuari B. si person zyrtar me veprimet e tij ka kryer veprën penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar duke shfrytëzuar detyrën zyrtare në atë mënyrë që ndërmerr veprimet të cilat formalisht janë në kuadër të autorizimeve të tij, pra rekomandimit të anëtarëve të komisionit vlerësues, por në kundërshtim me interesat dhe detyrat e shërbimit, duke ndërhyrë - detyruar anëtarin-kryetarin e komisionit E.A. të paraqesë kërkesë me shkrim për tërheqje nga komisioni vlerësuar, i caktuar me vendim të mëhershëm nga Sekretari i MI, i akuzuari Xh.B., pasi që ajo refuzonte të nderonte raportin vlerësues ku kishin rekomanduar tjetër operator, OE “F.”, ashtu që detyrën e tij zyrtare me qëllim e ka shfrytëzuar për ti sjell dobi operatorit “S.” duke shpërfillur interesat e shërbimit për të cilat kishte detyrë që të kujdesej.

Gjykata e Apelit duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, gjen se pretendimet e Prokurorit të shteti, për një dënim më ashpër se sa dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa ato të mbrojtësit e të akuzuarit Xh.B.-av.S.M., se dënimi i shqiptuar ndaj të këtij të pandehuri është tejet i lartë, është i pabazuar. Kjo për faktin se prokuroria e as mbrojtja e të akuzuarit Xh.B., në ankesë nuk thekson ndonjë rrethanë të re apo rrethanë konkrete të cilën gjykata nuk e ka vlerësuar me rastin e shqiptim të lartësisë së sanksionit penale ndaj të akuzuarve. Në anën tjetër, kjo Gjykatë gjen të bazuar pretendimin ankimor të mbrojtësve e të akuzuarit B.T. - av.A.V. e F.L., se në arsyetim të njëjtë të akuzuarit Xh., gjykata e shkallës së parë, i ka ulur dënimin nga 3 vite në 2 vite burg, ndërsa për B.T. lartësia e dënimit ka mbetur e njëjtë, dhe pse për të akuzuarin Xh.B., gjykata ka marrë si rrethanë lehtësuese faktin se ndaj tij nuk është duke u zhvilluar asnjë procedurë gjyqësore, element ky që lë të nënkuptohet indirekt

se ndaj B.T. zhvillimi i procedurave tjera gjyqësore ndaj tij është duke u marrë si rrethanë rënduese edhe pse nuk ishte administruar asnjë provë për të vërtetuar këtë gjendje faktike.

Nga arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar rrjedh se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar rrethanat, e që konform dispozitës së nenit 73 të KPRK-së ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Kështu, për të akuzuarin Xh.B. e B.T., gjykata, si rrethanë të vetme lehtësuese, mbi bazën e së cilës e ka shqiptuar dënimin për veprën penale për të cilën ngarkohen secili veç e veç ka marrë faktin se të akuzuarit kanë pas sjellje shumë të mira në gjykatë, si dhe ndaj të akuzuarit Xh.B. ka marrë për bazë faktin se ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale. Ndërsa, si rrethana rënduese gjykata e shkallës së parë ndaj këtyre të akuzuarve gjeti: shkallën e lartë të dashjes nga ana e të njëjtëve, kjo për faktin se që të dy secili nga pozicioni i vet, kishin planifikuar kryerjen e veprës penale, duke ndërmarrë veprime që me çdo kusht të arrihet qëllimi i paramenduar, po ashtu, duke pasur parasysh cilësitë personale të akuzuarve, të cilët janë njerëz me një nivel të lart të arsimit (superior), i akuzuari Xh., në prag të marrjes së gardës të doktorit të shkencave, në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm dhe UD Drejtorit të Prokurimit, në MI, atyre shoqëria iu ka besuar që të kenë pozita të larta menaxheriale dhe të vendosin lidhur me shpenzimin e parasë publike, kanë zgjedhur mënyrën më të ulët edhe atë duke i detyruar vartëset e tyre, për të ndërmarrë veprime konkrete për realizimin e qëllimit të tyre; dashjen e lart dhe këmbëngulësinë e të akuzuarve për kryerjen e veprës penale, ku nga ky veprim i tyre, qëllim primar nuk rezulton të jetë menaxhimi me përgjegjësi dhe kujdes i parasë publike, por, mundësimi i përfitimi material nga Kompania “S.”.

Gjykata e shkallës së parë, duke pasur parasysh të gjitha të lartcekurat në rastin konkret kundër të akuzuarve, vendosi që të ndaj të akuzuarit Xh.B. të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve ndërsa për të akuzuarin B.T. dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve si dhe për të dy të akuzuarit shqiptoi edhe dënimin plotësues, ndalimi i ushtrimit të profesionit në kohëzgjatje prej dy vite, dënime këto që do të ekzekutohen pasi që aktgjykimi të marrë formën e prerë, duke obliguar të njëjtit edhe në kompensimin e të dëmtuarës MI, në vlerë prej 29,824.18€, marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, duke konstatuar se një dënim i tillë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale me të cilën ngarkohen të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllim i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të

ardhmen dhe rehabilitimi i tyre; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata e Apelit pajtohet konstatimin e rrethanave për llojin e dënimit (*dënimit me burgim*) dhe në këtë drejtim në raport me të akuzuarin Xh.B. edhe kjo Gjykatë e gjen si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin për sanksion penale, pasi që gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar rrethanat të cilat kanë ndikuar në caktimin e llojit të dënimit, mirëpo në anën tjetër kjo Gjykatë gjen se në rrethanat e natyrës së njëjtë të konstatuar për të dy të akuzuar nga gjykata e shkallës së parë, ashtu si me të drejtë pretendon mbrojtja e të akuzuarit B., ka shqiptuar dënimin me burgim më të ashpër, dhe atë në raport me të akuzuarin tjetër, duke konsideruar kështu si rrethanë rënduese në mënyrë indirekte zhvillimin e procedurave tjera gjyqësore ndaj tij, edhe pse kjo nuk është argumentuar me provë konkrete, andaj kjo gjykatë duke i rivlerësuar të gjitha këto rrethana të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, sipas bindjes të këtij kolegji penal, japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se edhe me këto dënime do të arrihet qëllim i dënimit, që të parandalohen të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen edhe personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 dhe 403 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PAKR.nr.729/2022 më datë 12.09.2023

B. profesional

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

Endrit Ajeti

Vaton Durguti

Bashkim Hyseni

Afërdita Bytyçi